



Rregullimi i humbjes natyrale, tepricave, dëmtimit, prishjes, dhe shkatërrimit të produkteve për qëllime tatimore

Prishtinë, Kosovë

Prill 2024

I. HYRJE

Gjatë diskutimeve në forumet sektoriale të organizuara nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Ekonominë dhe Investimet në mars 2024, u ngrit edhe çështja e (mos)nlohjes së humbjeve natyrore, tepricave, dëmtimeve, shkatërrimit dhe prishjes së produkteve për qëllime tatimore. Duke pasur parasysh se këto çështje janë të lidhura ngushtë me Doganën e Kosovës (DK) për pjesën e taksave kufitare dhe me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për tatimin mbi të ardhurat, për të adresuar këtë çështje duhet të ndërmerren veprime nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferet (MFPT) e cila është përgjegjëse edhe për këto dy institucione.

Sa i përket DK, sfida e sektorit privat ka të bëjë me mos ekzistimin e normave standarde të humbjeve sipas produkteve, ashtu siç janë të përcaktuara në disa nga vendet e rajonit dhe BE-së. Këto standarde do të shërbenin për reduktimin e vlerës së taksës së akcizës, dhe, rrjedhimisht edhe TVSH-së në kufi, në rastet kur produktet e humbin sasinë e tyre gjatë transportit, magazinimit dhe përpunimit. Nga analiza e rregullimit ligjor të kësaj çështje vërejmë që projekt Kodi i ri Doganor, ashtu si në disa nga vendet e rajonit dhe BE-së, parasheh përcaktimin e këtyre normave standarde të humbjes në sasi së produkteve të cilat janë subjekt i taksës së akcizës. Projekt kodi parasheh që këto norma standarde të përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Në anën tjetër, sektori privat ka shprehur ankesa edhe për procesin e njohjes së humbjeve natyrore, tepricave, dëmtimeve, prishjes dhe shkatërrimit të produkteve për çështjet e tatimit në të ardhura nga ana e ATK-së. Edhe pse çështja e dëmtimeve, prishjes dhe shkatërrimit të produkteve rregullohet deri në një masë me legjislacionin tatimor në fuqi, bizneset kanë shprehur më shumë shqetësim me lidhur me procedurat e ndërlikuara për dokumentimin e tyre. Për më tepër, nuk ekzistojnë norma standarde për të përcaktuar për humbjet natyrore apo aspektet tjera që do ta thjeshtësonin këtë proces.

Marrë parasysh ankesat nga sektori privat, qëllimi i këtij raporti është të ofrojë informata mbi rregullimin aktual të këtyre çështjeve, analizimin e praktikave ndërkombëtare, si dhe ofrimin e një analize mbi implikimet e mundshme tek bizneset kur përballen me procedura që vështirësojnë njohjen e këtyre humbjeve.

Ky raport është i organizuar si në vijim. Në pjesën e dytë është paraqitur një analizë mbi ligjet dhe aktet nënligjore të cilat i shqyrtojnë çështjet e përmendura më lartë. Pjesa e tretë ka në fokus rregullimin e këtyre çështjeve në disa nga vendet e Bashkimit Evropian dhe rajonit. Në pjesën e katërt është paraqitur ndikimi i mos-nlohjes së humbjeve të një pjese të produkteve tek bizneset. Ndërsa në pjesën e fundit prezantohen rekomandimet.

II. RREGULLIMI AKTUAL

Parashtruesit e kësaj çështje kanë kërkuar që të nxirret ligji ose akti nënligjor përkatës që rregullon njohjen e humbjeve reale të produkteve.

Parashtruesit konsiderojnë se përmes legjislacionit, mund të caktohen alternativat e qarta për njohjen e humbjeve gjatë proceseve të punës për industri të caktuara (prishja, humbja, avullimi, humbja në peshë).

Ndërkaq, ata kanë shpjeguar se në industrinë e caktuara, humbja në sasinë e produkteve është e pashmangshme për shkak të proceseve të rregullta të punës.

Një problem real, siç janë shprehur kompanitë, është fakti se procedura aktuale e paraparë me ligj, merr disa ditë që nga iniciimi nga ana e tatimpaguesit. Kjo paraqet problem për shkak se duhen ruajtur sasitë e produkteve për hudson për ditë të tëra. Ata kanë propozuar që të vendosen normat standarde për industrinë ushqimore, të cilat do të aplikoheshin në mënyrë uniforme për të identifikuar humbjen e produkteve.

Legjislacioni tatimor

Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore

Ligji Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, i aprovuar së fundi, si akt që rregullon administrimin e procedurave tatimore, parasheh çështjen e humbjes së produkteve në paragrafin 13 të

nenit 15 të tij. Sipas kësaj dispozite, për përcaktimin e saktë të detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, ky i fundit duhet të dokumentojë mungesën e mallit me fakte të besueshme të lëshuara nga organet kompetente. Në mungesë të këtij dokumentimi, mallrat e tilla do të konsiderohen të shitura për qëllime të detyrimeve tatimore.

Fakti se mallrat e padokumentuara llogariten si të shitura për qëllime të llogaritjes së tatimit në të ardhura e reflekton realitetin. Megjithatë, në praktikë, siç janë deklaruar kompanitë, edhe në rastet kur dokumentohet humbja, por produktet nuk janë të matshme me njësi (copë), ATK nuk i njeh si shpenzime të zbritshme.

Përderisa akti nënligjor i cili përcakton zbatimin e këtij ligji duhet të nxirret brenda këtij viti, udhëzimi administrativ për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili tashmë është i shfuqizuar, këtë çështje e rregullon me nenet 24 dhe 25.

Sipas nenit 24 të këtij UA, kur një tatimpagues llogaritet të ardhurat e tij në bazën reale, shkatërron një pjesë të stokut për shkaqe të ndryshme, prishja e tillë mund të konsiderohet si shpenzim i aktivitetit ekonomik. Për t'u njohur kjo nga ATK, tatimpaguesi duhet të ofrojë dokumentacion të pranueshëm, në të kundërtën, mallrat konsiderohen si të shitura e tatohen në përputhje me ato rregulla.

Ndërkaq, neni 25 i këtij UA, parasheh se pjesa e mallrave të shkatërruara apo të dëmtuara nga fatkeqësia apo humbja për shkak të vjedhjes, mund të pranohet si shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore, përderisa plotësohen kushte specifike. Edhe në këtë rast, tatimpaguesi duhet të ofrojë evidencë të humbjes së mallrave.

Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe Ligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave

Kjo çështje rregullohet edhe përmes Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, si dhe Ligjit Nr. 06/L-105 për të Tatimin në Ardhurat e Korporatave. Çështja e humbjes parashihet në nenin 30, paragrafi 1.9, dhe nenin 9, paragrafin 1.9, tek secili ligj respektivisht. Të dy këto akte parashohin se gjatë përcaktimit të të ardhurave të tatueshme, nuk lejohet zbritje përtej normave të përcaktuara me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore për ato humbje, dëmtime, mbetje, teprica, shkatërtime apo thyerje gjatë prodhimit, transportimit, magazinimit dhe ekspozimit.

Pra, kërkohet që përmes një akti nënligjor, të përcaktohen normat maksimale për masën e humbur të produkteve në të gjitha fazat deri në shitjen e tyre. Një akt i tillë nënligjor nuk është nxjerrë akoma, duke e lënë të parregulluar këtë çështje.

Në shpjegim të kësaj dispozite, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016, për zbatimin e Ligjit për TAP, i parasheh si shpenzime të palejueshme shpenzimet e padokumentuara,

si dhe ato të cilat nuk i përmbushin kriteret e parapara me ligjin përkatës.

Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Një element tjetër me rëndësi për çështjen në fjalë, është momenti kur TVSH-ja bëhet e ngarkueshme për tatimpaguesin.

Si parim, Ligji Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e shtuar e saktëson në nenin 22 të tij se momenti kur lind detyrimi dhe kur TVSH-ja bëhet e ngarkueshme është momenti i furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

Ndërsa, sipas nenit 23, paragrafit 2.3 të këtij ligji, kur mallrat importohen, detyrimi tatimor lind në ditën në të cilën lind edhe detyrimi doganor. Për mallrat të cilat nuk i nënshtrohen detyrimeve doganore, TVSH-ja bëhet e ngarkueshme në ditën kur do të lindte detyrimi doganor sipas dispozitave ligjore për detyrimet doganore.

Legjislacioni doganor

Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave

Neni 203, paragrafi (c) i Kodit aktual Doganor dhe të Akcizave të Kosovës saktëson se, ndër të tjera, nuk lind asnjë detyrim doganor në rast se: “shfrytëzimi i procedurës doganore nën të cilën janë vendosur mallrat, rezulton nga asgjësimi i plotë ose humbja e pakthyeshme e këtyre mallrave, për shkak të vet natyrës së mallrave ose të rrethanave të paparashikuara ose fuqisë madhore, ose si

pasojë e autorizimit të lëshuar nga Dogana". Në terma të thjeshtëzuar, kjo do të thotë se një subjekt ekonomik nuk do të detyrohet të paguajë detyrime doganore në rast se ai produkt ka humbur në mënyrë të pakthyeshme, gjegjësisht është bërë i papërdorshëm.

Rregullimi sipas Projekt-Kodit Nr. 08/L-247
Doganor dhe të Akcizave

Tashmë projekt Kodi Doganor dhe i Akcizave është miratuar në lexim të dytë nga Kuvendi. Ky akt e trajton çështjen e humbjes së produkteve në mënyrë shumë më të detajuar.

Së pari, në nenin 88 të tij, ky akt i parasheh rastet në të cilat shuhet detyrimi doganor në import ose eksport.

Një nga këto raste, e paraparë me paragrafin 1.7 të këtij neni, është situata kur zhdukja ose humbja e mallrave, ose mosplotësimi i obligimeve nga legjislacioni doganor, rrjedhin nga shkatërrimi total ose nga humbja e pakthyeshme e këtyre mallrave. Deri këtu mund të arrihet si rezultat i natyrës së vetë mallrave, rrethanave të paparashikueshme të një force madhore, apo sipas udhëzimeve të Doganës. Me qëllim definimi, kjo dispozitë përcakton se humbjet konsiderohen të pakthyeshme kur mallrat bëhen të papërdorshme nga cilido person.

Në vijim, çështja e humbjes rregullohet edhe me nenin 198 të këtij projekt kodi, i cili flet për llogaritjen dhe pagesën e taksës së akcizës.

Në parim, obligimi për llogaritjen dhe pagesën e akcizës rrjedh me lëshimin e produkteve me akcizë në qarkullim të lirë në Kosovë. Megjithatë, siç përcaktohet me paragrafin 1.3 të këtij neni, ky obligim doganor nuk rrjedh kur evidentohet një mungesë ose humbje, qoftë gjatë prodhimit apo magazinimit, apo gjatë lëvizjes në sistemin e pezullimit të pagesës së akcizës.

Tutje, në dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, trajtohen rastet të cilat nuk përbëjnë lëshim në konsum të mallrave. Këtu përfshihen, së pari, rastet kur humbja apo shkatërrimi (jo edhe vjedhja) i atribuohen rasteve të paparashikuara ose forcës madhore, ose janë kryer si rezultat i shkatërrimit të produkteve të akcizës nën mbikëqyrjen doganore. Së dyti, mallrat nuk konsiderohen se janë lëshuar në konsum kur mungesa ose humbja është e lidhur pandashëm me karakteristikat e produktit dhe që ka lindur gjatë prodhimit, magazinimit dhe lëvizjes së produkteve të akcizës.

Ngjashëm, edhe në këto raste, produktet konsiderohen të shkatërruara/humbura në mënyrë të pakthyeshme kur të njëjtat nuk mund të përdoren më si produkte të akcizës.

Sa i përket humbjes apo mungesës së lëndëve të para, ose produkteve tjera të akcizës të cilat janë përdorur për prodhimin e produkteve në magazinë akcizore, obligimi doganor për akcizë lind sipas normativit të prodhimit me autorizim doganor.

Në këtë aspekt, humbja apo mungesa konstatohet si diferencë ndërmjet sasisë së

pritshme të prodhimit, normativave të procesit të prodhimit dhe koeficientëve të humbjes në prodhim, në bazë të autorizimit të magazinës akcizore për produktet e deklaruar si të prodhuara nga këto lëndë të para.

Për fund, ky nen e obligon Ministrinë përkatëse të Financave që, përmes një akti nënligjor, të përcaktojë rregullat dhe procedurat në lidhje me mungesën ose humbjen e produkteve të akcizës në sistemin e pezullimit të pagesës së akcizës gjatë prodhimit, magazinimit dhe lëvizjes, evidentimin, inventarizimin e humbjeve ose mungesave në sistemin e evidencave dhe kontabilitetit. Marrë parasysh këtë, pjesa e humbjes së pjesshme, në përputhje me përcaktimin në paragrafin 2 të këtij neni, që tejkalon shumë e përcaktuar me këtë akt nënligjor do të konsiderohet si lëshim në konsum. Kjo përveç rastit të dyshimit të arsyeshëm për mashtrim apo parregullsi.

Kjo paraqet edhe ndryshim substancial në raport me Kodin aktual në fuqi. Sipas Kodit në fuqi, pavarësisht limiteve të vendosura me shkallët standarde të humbjes, në rast se subjekti dëshmon se humbja reale i ka kaluar këto norma, këto të fundit nuk aplikohen.

Me të hyrë në fuqi ky akt, mbetet përgjegjësi e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që të nxjerrë aktin përkatës

nënligjor, e të vejë dritë mbi procedurat e aplikueshme lidhur me këtë çështje.

III. PRAKTIKAT NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE RAJON

Në Bashkimin Evropian, çështjet në lidhje me prishjen, avullimin dhe zhdukjen e produkteve trajtohen kryesisht nëpërmjet Rregullores Nr. 952/2013 mbi Kodin Doganor, si dhe Direktivave të tilla si 2008/118/EC mbi Rregullat e Përgjithshme mbi Akcizën.¹ Neni 124 i Rregullores mbi Kodin Doganor përshkruan kushtet në të cilat detyrimi doganor mund të shuhet, duke përfshirë rastet kur produktet humbasin në mënyrë të pakthyeshme për shkak të natyrës së tyre, ngjarjeve të forcës madhore dhe të ngjashme. Për më tepër, kjo rregullore përcakton se normat standarde për humbjet e parashikueshme zbatohen përveç rasteve kur biznesi dokumenton se humbja është më e lartë. Megjithatë, Direktiva 2008/118/KE u lejon shteteve anëtare të vendosin kushtet për të vërtetuar humbjet, veçanërisht gjatë transportit ose përpunimit.

Varësisht nga shteti anëtar i BE-së, aplikohen rregulla të ndryshme sa i përket njohjes së humbjeve, sidomos atyre mallrave për të cilat aplikohet akciza. Përderisa shumica e shteteve kanë norma standarde fikse për humbjen në sasi gjatë transportit të mallrave që kanë akcizë, një pjesë tjetër e shteteve, si Danimarka dhe Suedia, nuk aplikojnë norma fikse.² Shtetet të cilat aplikojnë norma fikse,

¹ Rregullore (BE) Nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit

² Normat e aplikuar në disa nga shtet anëtare të BE-së për humbjet për shkak të natyrës së mallrave të akcizës gjatë transportimit

zakonisht për përcaktimin e niveleve të humbjeve në sasi marrin parasysh kritere të ndryshme që lidhen me mënyrën e transportimit dhe kohëzgjatjen e transportit. Për shembull, në Bullgari normat standarde të lejuara për humbje natyrale të produkteve të alkool-it bazohen në mënyrën e magazinimit të produktit. Më specifikisht, nëse produkti është duke u bartur përmes fuqisë së drurit aplikohen norma tjera krahasuar me format tjera të magazinimit si përdorimi i kontejnerëve.

Sa i përket rajonit, Shqipëria i ka të përcaktuara normat standarde për humbjet në sasi për mallrat që kanë akcizë. Këto standarde ndahen në disa kategori duke përfshirë normat standarde për humbjet teknike në transport dhe operacioneve të thjeshta, humbjet natyrale, dhe humbjet gjatë proceseve të prodhimit dhe përpunimit.³ Për më tepër, në Shqipëri është marrë vendimi që i njeh edhe humbjet gjatë procesit të prodhimit për çështje fiskale si tatimi në të ardhura.⁴ Bazuar në këtë vendim, për produkte që kanë akcizë përdoren normat standarde veç se të përcaktuara. Ndërsa për produkte të tjera që përdoren si lëndë e parë gjatë procesit të prodhimit normat përcaktohen përmes kartave teknologjike që përshkruajnë procesin e prodhimit apo përpunimit. Këto karta teknologjike duhet të jenë të certifikuara nga një institucion i

njohur shtetëror që ka aftësi teknike të konfirmimit të tyre.

Sa i përket pjesës tjetër të rajonit, edhe vendet tjera ndjekin praktika të përdorimit të normave standarde për njohjen e humbjeve të produkteve finale, në rastet kur përdoren si lëndë e parë ose gjatë proceseve tjera nëpër të cilat kalojnë.

IV. NDIKIMI EKONOMIK

Ndikimi i përgjithshëm në ekonomi

Përcaktimi kuantitativ i ndikimit të humbjeve, dëmtimit, prishjes, dhe shkatërrimit të produkteve në ekonomi në mungesë të të dhënave të detajuara është mjaft sfiduese. Kjo për shkak të natyrës komplekse të produkteve të caktuara, natyrës së industrive, praktikave të transportit dhe magazinimit, karakteristikat e rregullimit ligjor të këtyre aspekteve dhe shumë faktorë tjerë që ndërlikohen me zinxhirin e furnizimit. Pavarësisht kësaj, nga studimi i praktikave në vende të ndryshme, vërejmë se janë disa aktivitete ekonomike të cilat janë të ndikuar në masë më të madhe nga humbjet e një pjese si të produkteve finale ashtu edhe humbjeve gjatë procesit të prodhimit dhe përpunimit. Këto aktivitete ekonomike përfshijnë, mes tjerash, prodhimin, përpunimin, tregtinë, kultivimin e kulturave bujqësor përfshirë blegtorinë,

³ Vendimi Nr.612, date 5.9.2012, për dispozitat zbatuese të ligjit për akciza


⁴ Vendim Nr.434, datë 20.5.2015 për përcaktimin e normave për firot humbjet, dëmtimet dhe skarcot

gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale

furnizimin me ujë dhe energji, transportin si dhe gastronominë.

Në figurën 1 është paraqitur struktura e Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike në vitin 2023.⁵ Bazuar në këto të dhëna, aktivitetet ekonomike të cilët ndikohen nga çështja e humbjeve përfaqësojnë rreth 55% të BPV-së në vitin 2023. Këto aktivitete përfshijnë: tregtinë me shumicë dhe pakicë, industrinë përpunuese, industrinë nxjerrëse, furnizimin me energji dhe bujqësinë. Ndërsa në aktivitet tjera marrin pjesë aktivitet ekonomike që nuk ndikohen nga humbjet e produkteve pasi që përfaqësojnë kryesisht shërbime.

Figura 1. Struktura e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike



Burimi i të dhënave: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Ndikimi tek bizneset

Mos njohja e humbjeve natyrale, dëmtimeve, prishjes, etj. e produkteve ka ndikim në rritjen e koston së bizneseve.

Përveç se humbin një pjesë të stokut, bizneset përfundojnë duke paguar tatime për produkte të cilat nuk dalin asnjëherë në qarkullim. Çdo kosto shtesë ndikon në kufizimin e biznesit në ngritjen e kapaciteteve përmes investimeve, gjë që do të ndikonte edhe në rritjen e fuqisë punëtore. Përderisa një pjesë e bizneseve këtë kosto shtesë mundohen ta mbulojnë përmes ngritjes së çmimeve për konsumatorët, disa biznese gjejnë forma tjera që ndikojnë në rritjen e informalitetit dhe evazionit fiskal duke deklaruar shitje fiktive si kompensim për koston shtesë të krijuara. Përdorimi i praktikave për shmangien e tatimeve ndikon që bizneset të cilat respektojnë rregullativën tatimore të përballen me një konkurrencë jo-fer. Kjo ndikon negativisht në perceptimin e këtyre bizneseve për institucionet qeveritare dhe shtetin në përgjithësi.

Mos njohja e humbjeve krijon një pasqyrë jo reale të bizneseve dhe ekonomisë në përgjithësi. Përballja me një situatë ku humbjet nuk njihen nga autoritetet tatimore mund të çojë në raportim financiar jo real nga ana e bizneseve. Ky raportim jo i saktë dëmton integritetin e pasqyrave financiare, duke shkaktuar një perceptim të gabuar jo vetëm për biznesin por edhe për industrinë në të cilën operon biznesi. Pasqyrat financiare janë burimi kryesor i informacionit edhe për investitorët potencial

⁵ Këto shifra janë vetëm vlerësime nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës; ato rishikohen në muajin shtator 2024.

përmes të cilave edhe analizohen kthimet në investime.

Përballueshmëria më një kosto shtesë e ulë konkurrueshmërinë e bizneseve edhe në tregun ndërkombëtar. Duke u përballur me këtë kosto shtesë, nga e cila ndikohen në masë më të vogël bizneset konkurruese nga shteti e rajonit dhe bota, pasi që e kanë të rregulluar këtë çështje në mënyrë më të përshtatshme, bizneset në Kosovë janë më pak konkurrues edhe në tregun ndërkombëtar.

Mos rregullimi adekuat i kësaj çështje ka ndikim negativ në perceptimin për të bërit biznes në Kosovë nga ana e investitorëve potencial. Përballimi i një pagese shtesë tatimore për shkak të mos njohjes së humbjeve të produkteve dekurajon investitorët potencial të investojnë në Kosovë sidomos kur në vendet e rajonit – konkurrentë për tërheqjen e investitorëve të huaj - kjo çështje është e rregulluar.

V. SHËNIME PËRMBYLLËSE DHE REKOMANDIME

Rregullimi i duhur i çështjes së njohjes së humbjeve të produkteve është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të të bërit biznes në Kosovë. Përderisa për bizneset vendore mungesa e rregullimit të duhur paraqet një kosto shtesë, për investitorët potencial mund të ndikojë negativisht në perceptimin të tyre për të bërit biznes në Kosovë. Duke marrë parasysh ndikimin e kësaj çështje është e rëndësishme që të ndërmerren hapa drejt adresimit në mënyrë adekuate si:

- Nxjerrja e aktit nënligjor për normat standarde të humbjeve për produktet akcizore nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Përpos agjencive ekzekutive si ATK dhe Dogana, është e rëndësishme të përfshihet edhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) në përcaktimin e këtyre normave standarde.
- Standardizimi dhe thjeshtëzimi i procedurave për njohjen dhe dokumentimin e dëmtimit, shkatërrimit, prishjes së produkteve nga ana e MFTP-së dhe ATK-së përmes udhëzimit të ri administrativ që pritet të përfundohet këtë vit në kuadër të ligjit të ri për administrimin e procedurave tatimore. Për arritjen e këtij qëllimi, akti i ri nënligjor duhet të parashohë edhe përfshirjen e institucioneve të tjera relevante që kanë aftësi teknike për dokumentimin e dëmtimit, shkatërrimit, prishjes dhe avarive të tjera të produkteve.
- Të konsiderohet mundësia e përcaktimit të normave standarde të humbjeve për produktet tjera jo akcizore për qëllime tatimore, përmes ligjit në të ardhura të korporatave dhe ligjit në të ardhura personale.